



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2021, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "SPORT**  
**MARKETING", SHA, NË PRISHTINË**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 10,000.00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, 22/616/16306, mjete nga të hyrat vetanake.

**III.**

Qëllimi i këtij Vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës ia ndan NPL-së "Sport Marketing", SHA, për shkak të situatës pandemike të krijuar nga virusi COVID - 19 dhe masave restriktive nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-451/01-87839/21, më 19.05.2021**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

